

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT	SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS	POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU
--	---	--

20 mars 2013

C-I.-12-0042

Përfaqësuar nga avokati [REDACTED]

Paditësi

Kundër

Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Rruga Ilir Konushevcit 8, Prishtinë
Përfaqësuar nga avokati [REDACTED] nga [REDACTED]

E Paditura

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Specializuar I, i përbërë nga gjyqtari kryesues Alfred Graf von Keyserlingk, gjyqtari Shkelzen Sylaj dhe gjyqtari Çerim Fazliji, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 20 mars 2013 lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Padia refuzohet si e pabazuar

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Më 8 qershor 2012 Paditësi parashtrroi një padi duke kundërshtuar vlefshmërinë e Vendimit të lëshuar nga e Paditura me 31 maj 2012 për “të ushtruar tërheqjen e aksioneve” mbi asetet e Nder e Re [REDACTED] e privatizuar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit me “spin-of special” më datë 10 gusht 2006. Paditësi deklaroi se ai, para kësaj, në mënyrë të rregullt ka fituar pronësinë e këtyre aksioneve dhe se e paditura nuk ka pasur të drejtë që ta revokojë shitjen e aksioneve dhe të ushtrojë Tërheqjen e Aksioneve më 31 maj 2012.

Paditësi, pastaj, ka parashtruar një kërkesë për lëshimin e një urdhri paraprak gjyqësor për të parandaluar AKP-në nga implementimi i Aktvendimit të kundërshtuar deri dy muaj pasi që padia të vendoset përfundimisht. Kolegji i Specializuar I me 25 qershor 2012 e ka refuzuar kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor si të pabazuar.

Me 27 shtator 2012 Kolegji i Apelit e ka prishur Aktvendimin e Kolegjit të Specializuar dhe pjesërisht e ka miratuar kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor deri në vendimin përfundimtar mbi meritën.

Në mbrojtjen e saj, e paditura deklaron se padia duhet të refuzohet si e pabazuar. E paditura deklaron se ka vepruar në pajtim të plotë me Kontratën e Privatizimit të datës 10 gusht 2006 dhe me Ligjin mbi AKP-në, duke se cekur se në pajtim me Kontratën e Privatizimit, paditësi është dashur t'i plotësojë zotimet para datës 13 tetor 2009. Zotimet janë: zotimi për investim 20.200.000,00 euro dhe zotimi për punësimin e 270 punëtorëve gjatë 6 muajve të parë dhe 540 në fund të 12 muajve. Në vend të kësaj paditësi i ka zbatuar vetëm 8.32% të investimeve të zotuara dhe 79.52 për qind d të zotimit për punësim. E paditura i referohet nenit 6.2.2 të marrëveshjes së zotimeve dhe neneve 1 dhe 8 të Ligjit mbi AKP-në. Pretendohet se neni 8.6 i Ligjit mbi AKP-në i jep mandat të paditurës që ta tërheq shitjen e privatizimit.

Paditësi pohon se kontrata e datës 10 gusht 2006, më vonë ishte ndryshuar dhe se e paditura ka kontribuar në dështimet dhe mos përmbushjen e obligimeve kontraktuese të paditësit. Ai mendon se në pajtim me Nenin 6.2 të marrëveshjes së zotimeve, tërheqja e aksioneve ushtrohet vetëm me anë të udhëzimeve me shkrim të Autoritetit Ushtrues dhe se në pajtim me nenin 1 të marrëveshjes së zotimeve, lidhur me definicionin "Autoritet Ushtrues" në rast se PSSP më nuk ekziston, ai do të zëvendësohet nga një tribunal i arbitrazhit i formuar në pajtim me procedurat e parashtruara në piken 9.3.2 (b) të Marrëveshjes. Paditësi thekson se kontrata qartazi i referohet një tribunali të pavarur dhe të paanshëm, i cili do të vendosë nëse palët i kanë përmbushur obligimet e tyre kontraktuese. Paditësi, më tej thotë se AKP si pasardhëse ligjore e AKM-së kë të drejtë vetëm të kërkoj nga Autoriteti Ushtrues lejen për ta ushtruar tërheqjen e aksioneve dhe jo edhe tërheqjen e shitjes me vendim të njëanshëm. Paditësi mendon se, pasi që nuk ka pasur asnjë arbitrazh, kthimi i shitjes është i pavlefshëm. Vendimi i kundërshtuar do ta cenonte Kushtetutën e Kosovës, Nenin 6 të KEDNJ dhe Nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNJ. Sipas Paditësit Dhoma e Posaçme mund të vendos vetë në lidhje me vlefshmërinë dhe, dhe në rast se nuk ndihet se nuk ka të drejtë të veprojë ashtu, duhet t'i referohet Gjykatës Kushtetuese në pajtim me Nenin 113 të Kushtetutës.

E Paditura konteston të jetë ndryshuar ndonjëherë Kontrata e datës 10 gusht 2006 e lidhur mes palëve dhe se e paditura të ketë kontribuar në dështimin e paditësit për të përmbushur kontratën.

Arsyetimi Ligjor

Padia është e pabazuar.

Vendimi i të paditurës i datës 31 maj 2012 për të ushtruar tërheqjen e aksioneve për aksionet të Ndërmarrjes së Re ██████████ është i vlefshëm.

1.

Paditësi me anë të marrëveshjes së zotimit të datës 10 gusht 2006 ka pranuar obligimin për të investuar një minimum prej 20.200.000, 00 euro dhe të punësojnë 270 punëtorë me kohë të plotë (apo të ngjashëm) me pagë për gjatë 6 muajve të parë dhe 540 punëtorë me kohë të plotë (apo të ngjashëm) në fund të 12 muajve pas datës së hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Zotimit. (neni 1.2, neni 1.3.1 dhe 2 i Marrëveshjes së Zotimit datë 10 gusht 2006).

Ai gjithashtu i kishte dhënë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit një tërheqje të aksioneve në rast të ndonjë shkeljeje të madhe të Zotimeve (neni 6.2 i Marrëveshjes së Zotimit datë 10 gusht 2006).

Kjo gjendje e kontratës ka mbetur e pandryshuar. Ka qenë e vlefshme kur e paditura ka ushtruar tërheqjen e aksioneve më 31 maj 2012. Pretendimi i paditësit se kontrata është modifikuar pas datës 10 gusht 2006 është kontestuar nga e paditura dhe paditësi nuk ka pretenduar dhe nuk ka specifikuar asnjë fakt që do lejonte supozimin në lidhje me modifikimin e kontratës. Deri më tani referenca është bërë tek urdhri për sqarim i datës 9 janar 2013 dhe tek parashtratat e paditësit të datës 24 janar 2013.

2.

Paditësi ka shkelur zotimet për investim dhe për punësim, kjo është e pakontestuar. Palët nuk pajtohen vetëm në lidhje me çështjen se deri në çfarë shkallë janë shkelur këto zotime. E paditura pretendon se paditësi e ka plotësuar obligimin për të investuar vetëm 8.32% dhe obligimin e tij për të punësuar vetëm 79,52%. Paditësi pretendon se ai ka plotësuar ato në shkallë më të lartë dhe se e paditura do të ketë kontribuar në mos përmbushjen. Megjithatë, e paditura ka parashtruar shifrat e sakta duke iu referuar raportit të auditorëve të [REDACTED] të datës 16 nëntor 2009. Prandaj, është paditësi ai që është dashur të kontestojë duke ofruar shifra të detajuara si dhe çdo kontribut të të paditurës që ka ndikuar në mos-përmbushjen e obligimeve nga paditësi është dashur të specifikohet në detaje nga ana e paditësit. Gjithashtu deri më tani deri më tani referenca është bërë tek urdhri për sqarim i datës 9 janar 2013 dhe tek parashtratat e paditësit të datës 24 janar 2013.

Gjykata vlerëson se shkeljet nga ana e paditësit janë të rënda.

Kjo do të thotë se Agjencia Kosovare e Privatizimit me të drejtë ka kthyer shitjen duke ushtruar tërheqjen e aksioneve.

3.

E paditura e ka fituar këtë të drejtë në bazë të nenit 31.3 të Ligjit Nr. 04/L-034, Ligji mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Ligji mbi AKP-në), i cili i ka transferuar të paditurës të gjitha asketet e mbajtura nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit.

Ligji mbi AKP-në me anë të cilit AKM zëvendësohet nga AKP është i plotfuqishëm në Kosovë (Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës Lënda me Nr. KL 25/10 të datës 4 shkurt 2010, paragrafi 55). Kolegji, si gjykatë vendore, i detyrohet këtij aktvendimi (neni 112.1 i Kushtetutës së Kosovës, Aktvendimi i Dhomës së Posaçme SCA-09-0042).

4.

Bordi i Drejtorëve të së paditurës në mënyrë të vlefshme ka mundur që të lëshojë tërheqjen e aksioneve. Nuk ka pasur nevojë për udhëzim me shkrim paraprak nga ana e PSSP siç është parashkruar me anë të nenit 6.2 të Marrëveshjes së Zotimeve dhe nuk ka pasur nevojë gjithashtu as për arbitrazh paraprak. Të dyja kushtet janë shfuqizuar me anë të nenit 31.4 të Ligjit mbi AKP-në. Autoriteti i PSSP-së është transferuar me anë të Ligjit tek Bordi i Drejtorëve i të paditurës. Në vend që PSSP të udhëzojë AKM-në në lidhje me miratimin e tërheqjes së aksioneve, tani Bordi i Drejtorëve i të paditurës mund ta miratojë tërheqjen e aksioneve pa ndonjë udhëzim. Nuk ka rëndësi nëse PSSP ekziston akoma pasi që Ligji i AKP-së i ka dhënë autoritet Bordit të Drejtorëve të së paditurës. Bordi i Drejtorëve i të paditurës nuk lë asnjë hapësirë për veprim të PSSP-së dhe gjithashtu nuk lë ndonjë hapësirë për arbitrazh. Sido që të jetë, arbitrazhi do të supozonte se PSSP nuk ekziston më. Ai ekziston. Detyrat e kompetencat e tij mund të kenë ndryshuar.

Ndryshimi i ligjit nuk nënkupton se e paditura, si palë në një marrëveshje zotimi dhe e paraparë për të qenë në cilësinë e një pale në një arbitrazh të mundshëm, ndryshon në pozitën

e një gjyqtari në lëndën e vetë. E paditura mbetet një palë që ushtron të drejtën e saj për një tërheqje të re të aksioneve. Mbetet e ekspozuar ndaj vlerësimit të pavarur gjyqësor të Dhomës së Posaçme për të vendosur nëse ka vepruar ligjërisht ose jo kur ka vepruar në atë mënyrë.

5.

Neni 31.4 i Ligjit mbi AKP-në nuk e shkel Kushtetutën e Kosovës.

Është e vërtetë se me anë të nenit 31.4 të Ligjit mbi AKP-në detyrat dhe të drejtat kontraktuale të palëve, të cilat dalin nga Marrëveshja e Zotimit, kanë ndryshuar. Paditësi e humb rastin që PSSP të mos udhëzojë një tërheqje të aksioneve dhe gjithashtu e humb të drejtën që të hyjë në arbitrazh në lëndën ku PSSP nuk ekziston më.

Megjithatë, këto humbje nuk janë jo kushtetuese. Ligjvënësi mund të modifikojë marrëdhëniet kontraktuale dhe këtë e bënë shpesh. Një Ligjvënës i tillë është jo kushtetues vetëm nëse ndryshimi ligjor i shkel të drejtat dhe garancitë e dhëna me kushtetutë.

Sipas nenit 2.1 të Kushtetutës së Kosovës, të drejtat dhe liritë e dhëna nga Konventa Evropiane për Drejtat e Njeriut janë të inkuorporuara në Kushtetutë. Kjo nënkupton se një shkelje e Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut domosdoshmërisht shkel edhe Kushtetutën e Kosovës.

Paditësi, duke iu referuar dy vendimeve të KEDNJ Stran Greek Refineries an Stratis Andreadis v. Greece (Aplikimi Nr.13427/87) dhe Zielinski dhe të tjerët v. France (ECHR1999-VII), pretendon shkelje të së drejtave për gjykim të drejtë (neni 6 (1) i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut dhe të drejtën për zotërim paqësor të posedimeve (Neni 1 i Protokollit Nr.1 (Pi-1)).

a.

Neni 1 (nen.6-1) i Konventës thotë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht ... nga një gjykatë ... në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile”

Eliminimi i të drejtës kontraktuale për arbitrazh nuk e ka ekspozuar paditësin pranë një gjykimi të drejtë. Kjo e drejtë për një gjykim të drejtë në Kosovë është e drejtë për t'u provuar drejtësisht nga ana e juridiksionit të Kosovës. Kjo e drejtë është e mbrojtur nga Konventa për të Drejtat e Njeriut dhe rrjedhimisht edhe nga Kushtetuta e Kosovës. Arbitrazhi kontraktues nuk është i mbrojtur me Kushtetutë. KEDNJ në lëndën Stran Greek Refineries an Stratis Andreadis v. Greece (Aplikimi Nr.13427/87), ka gjetur vetëm në një rast specifik dhe ekstrem që eliminimi i arbitrazhit ka qenë shkelje e gjykimit të drejtë.

Shteti grek, duke qenë palë kontraktuese, është dënuar nga gjykata e arbitrazhit me anë të një vendimi detyrues dhe të formës së prerë për të paguar dëmet. Gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Apelit kishin dhënë opinionin në favor të paditësit. Pastaj, pasi që shteti kishte kërkuar shtyrjen e seancës dëgjimore, ishte nxjerrë një ligj i ri, me anë të së cilit ishte mohuar përmbartimi i arbitrazhit të dhënë. Ky ligj i ishte përshtatur pikërisht lëndës së paditësit.

Dallimi i rëndësishëm në mes të kësaj lënde dhe lëndës në fjalë është se paditësi në lëndën në fjalë nuk ka pasur një aktgjykim nga arbitrazhi me anë të së cilit do të ishte aprovuar kompensimi i dëmeve, por kishte vetëm një pozicion kontraktues, i cili do të gjykohej me anë të arbitrazhit. Është e nevojshme që të ekzistojë një shkelje e drejtësisë procedurale nëse shteti si debitor zhvlerëson një titull, i cili paditësit do t'i jepte një të drejtë për kompensim. Gjithashtu, krijimi i një ligji, i përshtatur pikërisht për këtë procedurë dhe kundër këtij

paditësi, ka qenë i padrejtë. Megjithatë, kjo nuk nënkupton se shteti mund të mos ketë prishur arbitrazhin para se ky të ndodhte. Paditësi as nuk pretendon se ai do të kishte pasur sukses në parandalimin e të paditurës nga tërheqja e aksioneve në procedurën e arbitrazhit. Një gjë e tillë nuk është e mundshme pasi që zotimi financiar është përmbushur vetëm 8.32%.

Gjithashtu lënda Zielinski dhe të tjerët v. France (KEDNJ1999-VII) nuk është e krahasueshme me lëndën në fjalë për sa i përket gjykimit të drejtë. Gjithashtu në këtë lëndë ligjvënësi ka ndërhyrë në procedurë pasi që paditësi kishte marrë një aktvendim të favorshëm nga gjykata.

b.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (Pi-1) thotë

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij”

E drejta kontraktuale për të shkuar në arbitrazh nuk është posedim në kuptimin e kësaj dispozite. Vetëm një rezultat i favorshëm i një arbitrazhi të tillë, për shembull një përfitim monetar mund të bëhet një posedim. Gjithashtu KEDNJ nuk e ka kualifikuar si një posedim të drejtën për të shkuar në arbitrazh.

Si rezultat mund të thuhet se prishja e arbitrazhit me anë të Ligjit mbi AKP-në nuk është jo kushtetues. Prandaj, Kolegji duhet të aplikojë Ligjin e AKP-së edhe në rastin kur paditësi humbet arbitrazhin. Gjykata nuk referon pyetjen e përputhshmërisë kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese pasi që kolegji nuk është i sigurt në lidhje me pyetjen e përputhshmërisë (neni 113 Kushtetuta e Kosovës).

Padia është dashur që të refuzohet si e pabazuar.

Shpenzimet e Gjykatës

Gjykata nuk cakton shpenzimet e gjykatës pasi që presidiumi i gjykatës deri më tani nuk ka lëshuar një listë me shkrim të aprovuar nga Këshilli gjyqësor i Kosovës (Neni 57 Paragrafi 2 i Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), Kjo do të thotë se deri më tani nuk asnjë bazë të mjaftueshme për caktimin e shpenzimeve gjyqësore.

Këshillë Juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet Ankesë. **Ankesa e tillë mund të parashtrohet brenda 21 ditësh tek Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme.** Ankesa duhet t’i dërgohet edhe palës tjetër dhe të dorëzohet tek Trupi Gjyqësor **nga Ankuesi** brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Ankesave dëshminë se e ka dërguar Ankesën edhe tek pala tjetër.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Ankuesit i është dërguar aktgjykimi me shkrim.

Kolegji i Ankesave do ta refuzojë ankesën si të papranueshme nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.

E Paditura mund të ushtrojë përgjigje tek Kolegji i Ankesave brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar ankesa, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek pala tjetër.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në ankesën e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Ankesave dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Ankesave.

Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar Kryesues

[nënshkruar]